



## MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE (MNVZ)

### Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

Zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 27 prill 2014

---

### DEKLARATA E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PRELIMINARE

**Shkup, 28 prill 2014** – Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve preliminare është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, si dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE).

Christine Muttonen nga Austria është emëruar nga Kryesuesi i radhës i OSBE-së si Koordinatorë speciale për udhëheqjen e misionit afatshkurtër të vëzhgimit. Isabel Santos nga Portugalia e ka kryesuar delegacionin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, ndërsa Stefan Schennach nga Austria e ka udhëhequr delegacionin nga PACE. Ambasadori Geert-Hinrich Ahrens nga Gjermania është Shef i MVZ i OSBE/ODIHR-it, i vendosur në vend që nga 10 marsi 2014.

Vlerësimi është bërë për të përcaktuar nëse zgjedhjet janë në përputhshmëri me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike, obligimet ndërkombëtare si dhe legjislacionin vendas. Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve preliminare jepet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi final i zgjedhjeve do të varet pjesërisht edhe nga realizimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke e përfshirë edhe numërimin, mbledhjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe padive të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do ta publikojë raportin final gjithëpërfshirës me rekomandime për përmirësimet e mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Asambleja Parlamentare e OSBE-së do ta prezantojë raportin e saj më 28 qershor gjatë takimit të Komitetit të përhershëm në Baku. Delegacioni nga PACE do ta prezantojë raportin e vet më 23 maj gjatë takimit të Komitetit të përhershëm në Baku.

---

### PËRFUNDIMET PRELIMINARE

---

Si edhe gjatë rrethit të parë zgjedhor, edhe zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit 2014 janë administruar në mënyrë efikase, përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Kandidatët kanë pasur mundësi për ushtrim të papenguar të fushatës dhe është respektuar e drejta e tubimit dhe shoqërimit. Por, fushata e partisë qeverisëse nuk i ka ndarë në mënyrë adekuate aktivitetet partiake nga ato shtetërore, duke qenë në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardeve të Këshillit të Evropës. Gjatë tërë fushatës kanë vazhduar pohimet për frikësimin e votuesve. Partia shqiptare në qeveri ka vazhduar me bojkotin e zgjedhjeve presidenciale dhe ka ushtruar presion të tepërt mbi votuesit etnik shqiptarë për të mos e marrë fletëvotimin e zgjedhjeve presidenciale. Para fillimit të numërimit, koalicioni më i madh opozitar ka shpallur që nuk do t'i pranojë rezultatet e zgjedhjeve.

Mungesa e analizave politike dhe raportimit të pavarur në media ka vazhduar edhe gjatë rrethit të dytë të fushatës për zgjedhjet presidenciale dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Monitorimi i mediave që

është realizuar nga MVZ i OSBE/ODIHR ka treguar anësim të dukshëm nga shumica e mediave të monitoruara, në favor të partisë qeverisëse dhe kandidatit të saj presidencial, si dhe kryesisht negative ndaj partisë më të madhe opozitare dhe kandidatit të saj. Mediat shpesh herë kanë dështuar në dallimin mes raportimit për zyrtarët në rolin e ministrave dhe si kandidatë.

Janë zgjedhur 123 deputetë në parlament sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, si dhe 3 përmes sistemit të shumicës nga tre njësi zgjedhore jashtë vendit. Ndarja e pabarabartë e votuesve në njësitë jashtë vendit, si dhe dallimi mes numrit të votuesve në njësitë brenda dhe jashtë vendit nuk e sigurojnë në masë të plotë barazinë e votave, si që përcaktohet me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardet e Këshillit të Evropës. Më tej, kërkesa për dalje prej 40% në rrethin e dytë zgjedhor të zgjedhjeve presidenciale mund të rezultojë me cikle të zgjedhjeve të dështuara.

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor me të cilat përcaktohen rregullat e zgjedhjeve parlamentare janë ndryshuar në janar 2014, duke i trajtuar disa prej rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, mbesin disa pavijueshmëri dhe gjëra të dykuptimta të cilat ndikojnë në zgjedhjet parlamentare, përfshirë edhe përkufizimin ligjor dhe kohëzgjatjen e fushatës, si dhe dispozitat për shfrytëzimin e resurseve publike gjatë fushatës. Duke bërë përpjekje për ta rregulluar përputhjen e fushatës së dy zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka lëshuar disa udhëzime, të cilat në mënyrë efektive e kanë ndryshuar ligjin; kompetencat ligjore të KSHZ-së për këtë janë të diskutueshme.

KSHZ i ka respektuar pothuajse të gjitha afatet ligjore dhe ka mbajtur sesione të rregullta, por ka vazhduar të jetë e ndarë përgjatë linjave partiake për të gjithë çështjet kontestuese politike. Pavarësisht mbylljes së vonshme të listës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, shtypja e fletëvotimeve dhe ekstrakteve të listave zgjedhore është përmbjllur me kohë. Si edhe gjatë rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale, KSHZ nuk ka pasur komunikim efektiv me komisionet komunale zgjedhore (KKZ) për disa çështje, duke shkaktuar konfuzion mbi procedurat. Megjithatë, KKZ-të i kanë kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale.

Kriteri i barazisë gjinore është respektuar në trupat e administrimit zgjedhor. Në bazë të kërkesave ligjore, çdo vend i tretë në listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare ka qenë i rezervuar për gjininë me përfaqësim më të ulët. Prapëseprapë, femrat nuk kanë qenë mjaft të përfaqësuara në tubimet e vëzhguara nga OSBE/ODIHR dhe çështjet gjinore nuk janë trajtuar në programet e fushatës.

Për këto zgjedhje ka pasur dy lista të ndara zgjedhore: 1,779,572 votues të regjistruar për zgjedhjet presidenciale dhe 1,780,128 votues për zgjedhjet parlamentare. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së kanë shprehur shqetësime lidhur me saktësinë e listës zgjedhore dhe veçanërisht numrin e madh të votuesve të cilët banojnë në adresa të njëjta. Dispozitat ligjore me të cilat i mundësohet partive politike t'i sfidojnë të dhënat lidhur me regjistrimin në listën e votuesve janë të paqarta dhe nuk e përcaktojnë qartë se cili institucion është përgjegjës për realizimin e hetimit, që e ka penguar implementimin adekuat.

Fushata ka qenë aktive, me shumë tubime dhe takime me qytetarë. Por, avantazhi i dukshëm në aspektin e resurseve, së këndejmi edhe në reklamimin politik, ka nënkuptuar që Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas qeverisëse dhe kandidati i saj kanë dominuar në dy fushatat. Më tej, fushata e partisë qeveritare shpesh herë nuk e ka bërë ndarjen adekuate të aktiviteteve partiake dhe aktiviteteve shtetërore. Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, brenda blloqeve etnike janë shkëmbyer në mënyrë të vazhdueshme akuza të rënda për korrupsion. Bojkoti i zgjedhjeve presidenciale nga Bashkimit Demokratik për Integrim ka rezultuar me dalje dukshëm më të ulët të votuesve në rajonet etnike shqiptare, krahasuar me ato maqedonase.

Mekanizmi për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore ka mbetur joefektiv. Mungesa e afateve gjyqësore për zgjidhjen e disa llojeve të lëndëve zgjedhore, e kombinuar me të drejtat e kufizuara të votuesve për ndreqjen ligjore në çdo fazë të procesit zgjedhor, nuk e garantojnë ndreqjen e plotë efektive, si që kërkohet me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.

Dita e zgjedhjeve ka rrjedhur në mënyrë të papenguar dhe profesionale, me vetëm disa parregullsi teknike. Këshillat zgjedhorë (KZ) kanë treguar njohuri të mirë të procedurave të votimit. Por, në disa rajone etnike shqiptare, MNVZ ka vërejtur që anëtarët e KZ-ve i kanë dekurajuar votuesit nga marrja e fletëvotimit presidencial. Shumica e proceseve të numërimit dhe shpalljes të vëzhguara nga MNVZ janë vlerësuar si pozitive, ndonëse disa mospërputhje janë përmirësuar në procesverbalet e rezultateve.

---

## GJETJET PRELIMINARE

---

### Konteksti

Në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale është mbajtur më 13 prill 2014.<sup>1</sup> Meqë asnjëri prej kandidatëve nuk e ka fituar shumicën e nevojshme nga gjithsej votuesit e regjistruar, është shpallur rrethi i dytë mes presidentit në detyrë, Gjorge Ivanov, i ndërlidhur me VMRO-DPMNE-në, i cili ka fituar 51% të votave të hedhura,<sup>2</sup> si dhe Stevo Pendarovskit, i ndërlidhur me Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) në opozitë, që ka marrë 37,51% të votave të hedhura.<sup>3</sup>

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) e ka bojkotuar zgjedhjen e presidentit, duke cekur që partneri i saj i koalicionit VMRO-DPMNE i ka injoruar thirrjet e saj për propozimin e kandidatit konsensual, që do t'i përfaqësojë dy bashkësitë – maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë. Për pasojë, dalja e votuesve në rajonet etnike shqiptare ka qenë dukshëm më e ulët krahasuar me ato maqedonase.<sup>4</sup> Aplikimi i ngjyrës së dukshme për t'i shënuar votuesit ka kontribuar në presionin mbi qytetarët etnikë shqiptarë në rrethin e parë – vendimi i tyre për të votuar ose jo ka qenë i dukshëm.

Parlamenti është shpërndarë më 5 mars sipas nismës së BDI-së. Më 27 prill, janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare, së bashku me rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.

### Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor

Zgjedhjet rregullohen kryesisht nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, që është ndryshuar për here të fundit më 24 janar 2014 dhe i ka trajtuar disa rekomandime paraprake të OSBE/ODIHR.<sup>5</sup> Megjithatë, implementimi i legjisllacionit ka zbuluar që disa çështje dhe pavijueshmëri edhe më tej mbesin pa trajtim, përfshirë edhe përkufizimin ligjor dhe kohëzgjatjen e fushatës, si dhe dispozitat për shfrytëzimin e resurseve publike gjatë fushatës. Përveç kësaj, masat mbrojtëse për ndarjen e partisë nga shteti mbeten të pamjaftueshme. Nuk ekziston obligim ligjor që ministrat dhe zyrtarët tjerë shtetërorë të tërhiqen përkohësisht për të garuar si kandidatë, që rezultojnë me keqpërdorimin e resurseve shtetërore dhe konflikte interesi mes veprimeve zyrtare të ministrave dhe roleve të tyre si kandidatë.

---

<sup>1</sup> Deklarata e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake të NMVM-së për zgjedhjet presidenciale të 13 prillit mund të gjendet në <http://www.osce.org/odihr/elections/117636>.

<sup>2</sup> Për të fituar në rrethin e parë, kandidati i suksesshëm duhet ta fitojë shumicën e votave nga numri total i votuesve të regjistruar në listën zgjedhore. Z. Ivanov ka marrë 25.2% dhe z. Pendarovski 18.3% të votave nga totali i votuesve të regjistruar.

<sup>3</sup> Iljaz Halimi, kandidati i vetëm etnik shqiptar, i ndërlidhur me Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH) ka marrë 4.9%, ndërsa Zoran Popovski, i ndërlidhur me Opsionin qytetar për Maqedoninë (GROM) që është themeluar para ca kohësh ka marrë 3.61% prej votave të hedhura.

<sup>4</sup> Në komunat ku ka fituar z. Halimi, dalja e votuesve ka qenë 12.85%.

<sup>5</sup> Raportet paraprake të OSCE/ODIHR mund t'i gjeni në: <http://osce.org/odihr/elections/fyrom>.

Përfundim nga kjo bën Neni 9 i Kodit Zgjedhor, ku kërkohet që “personat zyrtarë të autorizuar” në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Mbrojtjes, t’i ndërpresin përkohësisht detyrat e tyre zyrtare pas konfirmimit si kandidatë. Kjo dispozitë e synon parandalimin e keqpërdorimit të resurseve zyrtare, si dhe evitimin e konfliktit të interesave që rrjedhin nga roli i dyfishtë i të qenit zyrtar në ndonjë ministri kyçe dhe kandidat gjatë periudhës zgjedhore. Dispozita në fjalë ka rëndësi të posaçme për Ministrën e brendshme, që ka pushtet mbi aspektet kyçe të procesit zgjedhor. Pavarësisht kësaj dispozite, Ministria e brendshme nuk është tërhequr nga detyra ndonëse ka garuar si kandidatë.<sup>6</sup>

Duke bërë përpjekje për ta rregulluar përputhjen e fushatës së dy zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka lëshuar disa udhëzime gjatë fushatës zgjedhore, të cilat në mënyrë efektive e kanë ndryshuar ligjin. Më 7 mars, KSHZ ka vendosur njëzëri për fillimin e fushatës parlamentare dy ditë më herët, me ndërprerje dyditore gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet presidenciale. Kompetencat ligjore të KSHZ-së për këtë janë të diskutueshme.

Në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale fiton kandidati që e fiton shumicën e votave të hedhura, me kusht që dalja e votuesve të jetë mbi 40% e numrit total të votuesve të regjistruar. OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) e kanë kritikuar këtë obligim më herët, meqë mund të rezultojë me cikle të zgjedhjeve të dështuara.<sup>7</sup>

Parlamenti zgjidhet për mandat katërvjeçar. Prej 123 deputetëve, 120 zgjidhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional në 6 njësi zgjedhore. Tre deputetët tjerë zgjidhen sipas sistemit të shumicës, në tre njësi jashtë vendit (Evropë dhe Afrikë, Amerikë veriore dhe jugore, Australi dhe Azi).<sup>8</sup> Ndarja e pabarabartë e votuesve në njësitë jashtë vendit, si dhe dallimi mes numrit të votuesve në njësitë brenda dhe jashtë vendit nuk e sigurojnë në masë të plotë barazinë e votave, si që përcaktohet me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>9</sup>

## Administrimi zgjedhor

Ngjashëm me zgjedhjet presidenciale, edhe zgjedhjet parlamentare janë administruar nga administrata zgjedhore në tre nivele: KSHZ, 80 komisionet komunale zgjedhore (KKZ), 3,480 këshillat zgjedhore (KZ) brenda vendit, si dhe 34 KZ në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK). KSHZ përbëhet prej shtatë anëtarëve të emëruar nga parlamenti, me mandat katërvjeçar. Kryetari dhe dy anëtarë propozohen nga partitë opozitare, ndërsa zëvendëskryetari dhe tre anëtarë nga partitë qeverisëse.

KKZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunat gjegjëse dhe për emërimin e KZ-ve. Komisionet komunale zgjedhore përbëhen nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të përzgjedhur sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë, për mandat pesëvjeçar. KZ-të krijohen nga KKZ-të përmes modelit të përzier profesional-politik, ku një anëtar propozohet nga partitë politike

---

<sup>6</sup> Neni 32 i Ligjit për punë të brendshme përcakton që “Ministri, Zëvendës-Ministri, Sekretari shtetëror, Drejtori i Byrosë së Sigurisë Publike, Drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim, si dhe të punësuarit tjerë në pozita udhëheqëse në MPB kanë status të personave të autorizuar zyrtarë”.

<sup>7</sup> Shikoni Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut për Kodin Zgjedhor (2013), ku ceket që “ruajtja e pragut aktual për dalje në rrethin e dytë (ku kërkohet shumica e votave me prag prej 40% të votuesve të regjistruar) mund të shkaktojë cikle të zgjedhjeve të dështuara”. <http://www.osce.org/odihr/elections/102832>

<sup>8</sup> Numri i votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore 7 (Evropa dhe Afrika) ka qenë 18,911 votues. Në njësinë 8 (Amerikë veriore dhe jugore) 3,337 votues, ndërsa njësinë 9 (Australia dhe Azia) ka pasur 1,534 votues. Në vend, mesatarja e votave për çdo kandidat të zgjedhur ka qenë rreth 14,600.

<sup>9</sup> Paragrafi 7.3 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që shtetet-pjesëmarrëse duhet “ta garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votimit për qytetarët e moshës madhore”. Më tej, shikoni Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut (2011), ku ceket që “prezantimi i sistemeve të ndryshme zgjedhore për votimin jashtë vendit, krahasuar me atë në vend, nuk duket i arsyeshëm”. <http://www.osce.org/odihr/84226>

qeverisëse, një nga partitë opozitare dhe tre anëtarë sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë. Kodi zgjedhor është ndryshuar me dispozitën ku kërkohet që kryetarët e KZ-ve të kenë diplomë universitare, ndërsa anëtarët të kenë arsim të mesëm, që ka pasur ndikim pozitiv në punën e KZ-ve, ndonëse disa KKZ kanë hasur në vështirësi për përzgjedhjen e numrit të mjaftueshëm të personave të kualifikuar për këtë.

Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, sesionet e KSHZ-së kanë qenë kryesisht të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe mediat. Procesverbalet e sesioneve janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së brenda 48 orëve. Megjithatë, sesionet e KSHZ-së edhe më tej janë veçuar me ndarjen mes anëtarëve dhe votimin përgjatë linjave partiake për të gjitha çështjet e diskutueshme politike. Pavarësisht mbylljes së vonshme të listës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, shtypja e fletëvotimeve dhe ekstrakteve të listave zgjedhore është përmblyllur me kohë.<sup>10</sup> KSHZ e ka përmbushur obligimin e saj për realizimin e fushatës për edukimin e votuesve, por ajo nuk ka qenë shumë e dukshme dhe nuk janë mbuluar aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor.<sup>11</sup> Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, mungesa e komunikimit mes KSHZ-së dhe KKZ-ve për disa çështje procedurale ka shkaktuar konfuzion mbi procesin. Megjithatë, KKZ-të i kanë realizuar detyrat e tyre profesionalisht.

### Regjistrimi i votuesve

Meqë zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare janë shpallur në data të ndryshme, ka pasur afate të ndryshme për shikimin e listave dhe përmblylljen e listave zgjedhore. Kjo ka rezultuar me dy lista të ndryshme zgjedhore, ku për zgjedhjet presidenciale janë regjistruar 1,779,572 votues, ndërsa për zgjedhjet e parakohshme parlamentare ka 1,780,128 votues të regjistruar.<sup>12</sup> Prej rreth 83,500 qytetarëve të regjistruar në MPB si shtetas me banim ose punë të përkohshme jashtë vendit, janë regjistruar 8,332 për të votuar në zgjedhjet presidenciale, gjegjësisht 23,782 për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.<sup>13</sup>

Çështja e numrit të madh të votuesve të cilët banojnë në një adresë, ku nuk duket se jetojnë është ngritur edhe më tej nga disa bashkëbisedues të OSBE/ODIHR-it. Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, BDI dhe LSDM kanë parashtruar kundërshtime në KSHZ për shlyerjen e votuesve nga lista zgjedhore parlamentare, duke pohuar që ata janë regjistruar në adresa fiktive (*lexoni Kundërshtimet dhe paditë*). Ministria e Punëve të Brendshme, e cila e mban regjistrin e popullatës, është prononcuar që nuk është përgjegjëse për verifikimin e pohimeve të këtilla. Dispozitat ligjore të cilat ia lejojnë partive politike kundërshtimin e regjistrimeve në listën zgjedhore, janë të paqarta dhe nuk theksojnë saktë se cili institucion është përgjegjës për hetimin e kundërshtimeve, që e ka penguar zbatimin e drejtë.

### Regjistrimi i kandidatëve

Në zgjedhjet parlamentare mund të garojnë kandidatët e propozuar nga partitë politike, koalicionet e partive politike ose kandidatët e pavarur të propozuar nga grupe votuesish. Çdo qytetar me të drejtë vote mund të garojë si kandidat në zgjedhjet parlamentare, përderisa nuk janë në kryerje të dënimit me burg prej të paktën 6 muajve për ndonjë vepër penale. Kandidatët mund të gjenden vetëm në një listë kandidatësh. Në drejtim të nxitjes së pjesëmarrjes së femrave dhe në pajtim me dispozitat ligjore, një në çdo tre vende të njëpasnjëshme në listën e kandidatëve rezervohet për gjininë me përfaqësim më të ulët.

<sup>10</sup> Lista zgjedhore për zgjedhjet parlamentare është mbyllur më 17 prill 2014, tetë ditë pas afatit ligjor.

<sup>11</sup> Fushata për edukimin e votuesve nuk i ka përfshirë rregullat e reja që vlejné për votim në shtëpi. Përveç kësaj, nuk janë informuar votuesit që mund të vendosin nëse do të votojnë ose jo për dy zgjedhjet më 27 prill.

<sup>12</sup> Qytetarët me moshë të mbushur 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve, të cilët që kanë vendbanim në njësinë gjegjëse zgjedhore, kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme biometrike dhe të cilëve nuk ju është marrë aftësia e veprimtimit juridik me vendim gjyqësor përfshihen në listat zgjedhore për votim në vend.

<sup>13</sup> Më 16 marsh, KSHZ ka shpallur që janë regjistruar 70,305 votues në MPB si persona të cilët përkohësisht jetojnë ose punojnë jashtë vendit. Për rrethin e dytë, KSHZ ka dhënë numër tjetër – 83,503 votues të cilët jetojnë jashtë vendit.

KSHZ ka regjistruar 9 parti politike dhe 5 koalicione në një proces përfshirës. Të gjitha partitë etnike shqiptare kanë garuar veças, përfshirë BDI-në dhe Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH). Ndonëse kjo mundësohet nga ligji, nuk është parashtruar asnjë listë e kandidatëve të pavarur.

## Fushata

Fushata për rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale ka filluar më 14 prill. Fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare ka filluar më 5 prill, me ndërprerje dyditore gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet presidenciale. Kandidatët kanë pasur mundësi për ushtrim të papenguar të fushatës. Fushata e garuesve presidencialë dhe parlamentarë është dominuar nga VMRO-DPMNE. Përveç kësaj, fushata e partisë qeverisëse nuk i ka ndarë në mënyrë adekuate aktivitetet partiake nga ato shtetërore, duke qenë në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>14</sup> Pohimet për frikësimin e votuesve dhe keqpërdorimin e resurseve shtetërore kanë vazhduar gjatë tërë fushatës.<sup>15</sup> MVZ i OSBE/ODIHR ka pranuar disa pohime të besueshme për presion mbi votuesit, të ushtruar veçanërisht mbi nëpunësit e sektorit publik, ku përfshihet presioni për pjesëmarrje në ngjarjet e fushatës<sup>16</sup> (ndonjë herë edhe gjatë orarit të punës)<sup>17</sup>, presioni për të mos marrë pjesë në ngjarjet e kundërshtarëve<sup>18</sup>, si dhe premtimet ose kërcënimet për punësim në sektorin publik.<sup>19</sup> Pretendimet tjera e kanë përfshirë kërcënimin për ndërprerjen e ndihmës sociale dhe blerjen e votave tek grupet me gjendje të vështirë ekonomike.

Metodat e fushatës i kanë përfshirë billbordet, pllakatet dhe fletushkat. Ka pasur shumë tubime nga koalicionet dhe partitë kryesore, të cilat kanë garuar për në parlament. Billbordet dhe pllakatet e dy kandidatëve të mbetur presidencialë kanë qenë të dukshme në shumicën e qyteteve. Sa i përket fushatës parlamentare, kanë mbizotëruar materialet e promovimit për udhëheqësit dhe bartësit e listave të koalicioneve dhe partive më të mëdha (VMRO-DPMNE, LSDM dhe BDI), ndërsa ka pasur më pak për Opsionin qytetar për Maqedoninë (GROM), PDSH-në, Rilindjen Demokratike Kombëtare (RDK), si dhe Koalicionin për Maqedoni Pozitive.

VMRO-DPMNE dhe LSDM, secila ka mbajtur tubime të përbashkëta për kandidatët e tyre presidencialë dhe parlamentarë. Të gjitha partitë dhe koalicionet janë përqendruar në mbajtjen e tubimeve më të vogla dhe fushatës derë-më-derë, si mënyrë kryesore e komunikimit me votuesit, diskutimit për programin dhe prezantimin e afisheve dhe fletushkave. Tubimet e vëzhguara nga MVZ i OSBE/ODIHR kanë rrjedhur pa pengesa<sup>20</sup> dhe në përgjithësi kanë pasur përcjellje të mirë, ndonëse meshkujt kanë dominuar.<sup>21</sup> Sidoqoftë,

<sup>14</sup> Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 e përcakton “ndarjen e qartë mes Shtetit dhe partive politike. Në veçanti, partitë politike nuk mund të mishërohet me Shtetin”. Shikoni edhe paragrafin I.3.1 të Kodit të Komisionit të Venedikut për praktikën e mirë. Për më tepër: <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD%282002%29023-e>.

<sup>15</sup> Më tej, MVZ i OSBE/ODIHR ka marrë shumë raporte, sipas të cilave policia nuk i ka hetuar pohimet e partive opozitare.

<sup>16</sup> Në tubimin e organizuar nga GROM në Gjorçe Petrov më 8 prill, vëzhguesve afatgjatë të OSBE/ODIHR-it ju është afuar nëpunësit shtetërorë, që e kanë kërkuar vendin ku duhet të nënshkruhet për prani. Një mësimdhënës në Gostivar ka raportuar që kolegëve ju është thënë nga eprori që të marrin pjesë në tubimin e BDI-së në Shkup, si dhe që kryetari i komunës i ka kërkuar listat e të pranishmëve në tubim.

<sup>17</sup> Gjatë tubimit të VMRO-DPMNE-së në Konçe më 15 prill, në periudhën 13:00-14:30 (gjatë orarit të punës), vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it kanë raportuar që objekti komunal ka qenë i mbyllur.

<sup>18</sup> Vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it janë informuar që nëpunësit publikë ju është ushtruar presion që të mos marrin pjesë në ngjarjet e fushatës së z. Pendarovski në Komunën Vallandovë.

<sup>19</sup> Një mësimdhënës në Gostivar i ka raportuar vëzhguesve afatgjatë që ka qenë e kërcënuar nga eprori që të tërhiqet nga kandidatura për RDK-në dhe të kalojë në BDI, në të kundërtën do ta humb vendin e punës. Përfaqësuesi i PDSH-së në Likovë i ka informuar vëzhguesit afatgjatë që ka qenë i zhvendosur nga vendi i punës (në sektorin publik), me qëllim që sipas pohimit të tij, “të qëndrojë jashtë qytetit gjatë zgjedhjeve për shkak të përkatësisë së tij politike”.

<sup>20</sup> Përfundimisht bën grindja mes mbështetësve të VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së pas një tubimi në rrugë me z. Pendarovski në Lisiçe më 15 prill.

<sup>21</sup> MVZ i OSBE/ODIHR ka vëzhguar 48 tubime gjatë periudhës së fushatës mes dy rrethëve zgjedhore. Niveli mesatar i pjesëmarrjes së femrave në tubimet e vëzhguara nga vëzhguesit afatgjatë të OSBE/ODIHR-it ka qenë 20%, me përfaqësim dukshëm më të ulët në ngjarjet e fushatave të PDSH-së dhe BDI-së.

me afrimin e ditës së zgjedhjeve, është rritur numri i rasteve të shkatërrimit të shtabeve partiake zgjedhore.<sup>22</sup> Gjatë fushatës, LSDM ka dorëzuar dëshmi në prokurori, duke pretenduar që kryeministri ka pranuar ryshfet për privatizimin e “Makedonska Banka”. Duke reaguar ndaj këtyre pohimeve, kryeministri ka shpallur që do të parashtrojë padi për shpifje kundër udhëheqësit të LSDM-së.

Çështjet dhe prioritetet kryesore të kandidatëve për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare, janë pasqyruar në programet e koalicioneve dhe partive, duke e përfshirë zhvillimin ekonomik, investimet e huaja, uljen e varfërisë, papunësinë e të rinjve, eliminimin e ndarjeve etnike, zgjidhjen e çështjes së emrit, integrimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO).

Fjalimet në tubimet e PDSH-së kanë vazhduar të veçohen me gjuhë nxitëse kundër BDI-së, veçanërisht kryetarit Ali Ahmeti.<sup>23</sup> Akuzat e vazhdueshme të padëshmuara të rasteve personale të korrupsionit brenda blloqeve etnike, e kanë ulur nivelin e diskursit dhe e kanë lëvizur fokusin nga çështjet konkrete dhe platformat partiake. Mospajtimi brenda PDSH-së, mes selisë partiake dhe degës në Strugë lidhur me listën e kandidatëve në njësinë e pestë zgjedhore kanë rezultuar me bojkotim të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nga dega në këtë komunë.

Më tej, dy partitë e koalicionit qeverisës (VMRO-DPMNE dhe BDI) i kanë shtuar apelet e tyre drejt bashkësive gjegjëse etnike për dhënien e numrit të mjaftueshëm të mandateve, me qëllim që ta përforcojnë pozitën e tyre dhe për ta evituar gjendjen ku do të duhet të bëjnë lëshime gjatë negociatave të ardhshme për krijimin e qeverisë. Kryeministri i ka bërë thirrje të vazhdueshme maqedonasve etnikë që t'i japin partisë shumicë të qartë prej të paktën 62 ulëseve, për të evituar çdo presion, ndikim ose kushtëzim nga partneri i saj i koalicionit, BDI.<sup>24</sup> Në ndërkohë, BDI ka kërkuar nga mbështetësit e saj që të votojnë në numër sa më të madh në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, për t'i mundësuar partisë ta fitojë numrin maksimal të ulëseve, me qëllim që ta përmirësojë pozitën në negociata. Si edhe në rrethin e parë, BDI ka shpallur që do ta vazhdojë bojkotin e saj në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe ka ushtruar presion të tepërt mbi votuesit e saj, që të përmbahen nga marrja e fletëvotimit presidencial.<sup>25</sup>

## Financimi i fushatës

Më 12 prill, katër kandidatët presidencialë i kanë dorëzuar raportet e dyta financiare, që janë publikuar me kohë. Z. Ivanov ka paraqitur gjithsej 29,337,922 MKD të hyra prej 1,615 donatorëve, si dhe të dala me vlerë prej 41,378,871 MKD.<sup>26</sup> Të hyrat totale të paraqitura nga z. Pendarovski janë 6,638,409 MKD prej 9 donatorëve dhe burimeve tjera, si dhe të dala prej 6,157,282 MKD. Raportet e para financiare të partive të cilat marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare janë dorëzuar më 17 prill dhe janë publikuar me kohë. VMRO-DPMNE ka paraqitur gjithsej 52,233,654 MKD të hyra dhe 43,907,166 MKD të dala. LSDM ka paraqitur të hyra prej 8,054,000 MKD dhe të dala 8,028,077 MKD. Të hyrat e deklaruara nga BDI janë

<sup>22</sup> Në polici janë raportuar këto dëmtime të zyrave: 4 të LSDM-së, 3 të VMRO-DPMNE-së, 1 të GROM-it, 1 të BDI-së dhe 1 të Aleancës për Maqedoni Pozitive. Dëmtimi i zyrës së LSDM-së në Çair nuk është raportuar në polici.

<sup>23</sup> Në tubimin më 15 prill, udhëheqësi i PDSH-së Menduh Thaçi ka pohuar që z. Ahmeti dhe BDI i kanë mësuar maqedonasit etnikë si t'i bëjnë shantazh shqiptarëve etnikë.

<sup>24</sup> Për shembull, në tubimin në Shtip më 11 prill, z. Gruevski ka thënë që partisë i nevojiten 62 ulëse për t'i dhënë përgjigje shantazheve nga krahu radikal i BDI-së. Në tubimin në Vallandovë më 15 prill, z. Gruevski ka thënë që tashmë është e qartë se kush do t'i fitojë zgjedhjet, por nuk është e njëjtë nëse do të fitohen më pak ose më tepër se 62 ulëse në parlament. Në tubimin në Kumanovë më 23 prill, Ministrija e brendshme ka thënë që çdo votë është e vlefshme, meqë “nuk dëshirohemi që të jemi nën shantazh nga dikush në realizimin e çështjeve nacionale”.

<sup>25</sup> MVZ i OSBE/ODIHR ka marrë pohime të besueshme për presionin e BDI-së mbi votuesit etnikë shqiptarë në rrethin e parë, përfshirë edhe porositë tekstuale të dërguara mbrëmjen e 12 prillit, duke kërkuar nga shqiptarët etnikë që të mos votojnë ditën e ardhshme; praninë e mbështetësve të BDI-së më 13 prill para vendotimeve duke i thënë njerëzve të mos votojnë, si dhe praninë e vëzhguesve të Asociacionit të qytetarëve për demokracizim dhe ngritje të vetëdijes publike (VEPRO) në vendotime ku i fotografojnë dhe regjistrojnë ata që votojnë.

<sup>26</sup> Shumat e cekura i përfshijnë dy rrethet zgjedhore presidenciale. EUR=61 MKD.

12,699,597 MKD dhe 18,957,018 MKD të dala. PDSH ka paraqitur 60,000 MKD gjithsej të hyra, si dhe të dala prej 130,626 MKD.

Në përgjithësi, sistemi i financimit të fushatës, si që zbatohet aktualisht, nuk është adekuat për ta siguruar transparencën, integritetin dhe llogaridhënien e procesit. Formulari për raportim financiar nuk kërkon që pjesëmarrësit zgjedhorë t'i paraqesin të hyrat dhe të dalat sipas artikujve. Ligji nuk e përcakton revizionin e raporteve financiare para-zgjedhore dhe nuk parasheh sanksione për mos parashtrimin e tyre. Enti Shtetëror për Revizion nuk ka mjete për të hetuar nëse pjesëmarrësit kanë të hyra ose të dala të padeklaruar.

## Mediat

Mungesa e analizave politike dhe raportimit të pavarur ka vazhduar edhe gjatë rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Monitorimi i mediave që është realizuar nga MVZ i OSBE/ODIHR ka treguar që shumica e mediave të monitoruara, kanë anuar dukshëm në favor të VMRO-DPMNE-së qeverisëse dhe kandidatit të saj z.Ivanov, kryesisht kundër LSDM-së dhe kandidatit të saj.<sup>27</sup> Më tej, mediat në gjuhën shqipe e kanë favorizuar BDI-në kundrejt të gjithë garuesve tjerë etnikë shqiptarë. Gjatë fushatës parlamentare, mediat janë fokusuar kryesisht në aktivitetet e dy koalicioneve më të mëdha politike (VMRO-DPMNE dhe LSDM), duke i kushtuar vëmendje të kufizuar rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale.

Kodi zgjedhor i obligon mediat e transmetuara t'i mbulojnë kandidatët për zgjedhjet parlamentare në mënyrë të drejtë, të baraspeshuar dhe të paanshme. Përveç kësaj, transmetuesi publik, "Radiotelevizionit Maqedonas" (RTM) obligohet që një të tretën e edicionit informativ t'ia kushtojë ngjarjeve lokale dhe ndërkombëtare, një të tretën për aktivitetet e partive politike qeverisëse, ndërsa një të tretën për aktivitetet e partive në opozitë sipas rezultatit të zgjedhjeve të fundit parlamentare. Këto obligime ligjore nuk janë në pajtim të plotë me paragrafin 7.8 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990, meqë nuk i sigurohet kohë garuesve tjerë.<sup>28</sup> Bazuar në rekomandimet e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), RTM ka siguruar kohë plotësuese në edicionet informative për partitë joparlamentare. Programi në gjuhën shqipe, RTM-2 i ka kushtuar hapësirë më të madhe raportuese partive etnike shqiptare nga ajo që kërkohet me ligj, që gjithashtu është bazuar në rekomandimet e ASHMAA.

Më 17 prill, ASHMAA i ka prezantuar rezultatet e monitorimit të saj të mediave për rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale. Këto rezultate kanë përmbajtur të dhëna sasiore,<sup>29</sup> kryesisht duke i përjashtuar rezultatet cilësore të monitorimit. Kjo e ka parandaluar agjencinë nga identifikimi i shkeljeve të mundshme, lidhur me obligimin ligjor që të gjithë transmetuesit të sigurojnë raportim të drejtë dhe paanshëm. Përveç kësaj, raporti i monitorimit ka cekur mungesë të baraspeshës sasiore të disa transmetuesve. Sidoqoftë, ASHMAA nuk ka reaguar.<sup>30</sup>

Sipas rezultateve të monitorimit nga MVZ i OSBE/ODIHR, partitë qeverisëse janë mbuluar në mënyrë më pozitive në RTM. Ndërkohë që të gjithë garuesit janë mbuluar në mënyrë kryesisht neutrale, VMRO-

---

<sup>27</sup> MVZ i OSBE/ODIHR ka monitoruar raportimin e RTM-1, RTM-2, Sitel, Kanal 5, Alfa, Telma dhe Alsat-M në kohën me shikueshmëri më të lartë (18:00-24:00). Për TV Vesti 24 janë monitoruar dy edicionet kryesore të ditarit (20:00 dhe 22:00).

<sup>28</sup> Paragrafi 7.8 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që "asnjë pengesë administrative ose ligjore nuk duhet ta pengojë qasjen e papenguar ndaj mediave, pa diskriminim për grupet politike dhe individët të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në procesin zgjedhor".

<sup>29</sup> Disa anëtarë të ASHMAA e kanë kritikuar mungesën e analizës cilësore në raport, që në fakt kërkohet sipas metodologjisë së ASHMAA-së për monitorimin e mediave.

<sup>30</sup> Raporti i ASHMAA-së për monitorimin e mediave ka cekur që z. Ivanovit i është dhënë periudhë më e gjatë raportuese në edicionet informative të TV Sitel, krahasuar me të gjithë kandidatët tjerë së bashku. Por, ASHMAA nuk ka iniciuar procedurë të kundërvajtjes, duke shpjeguar që ky mbulim është rezultat i "qasjes strategjike të VMRO-DPMNE-së [...] për ta shoqëruar vazhdimisht kandidatin presidencial, Gjorgje Ivanov".



DPMNE ka qenë në përparësi duke pasur mbulim pozitiv, ku theksohen të arriturat dhe projektet e ardhshme. RTM-2 ka pasur qasje të ngjashme, duke siguruar raportim pozitiv dhe neutral për aktivitetet e BDI-së, si dhe kryesisht neutral për garuesit tjerë zgjedhorë.

Gjatë fushatës, televizionet private *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* i kanë kushtuar 46-51% të edicioneve informative raportimit pozitiv ose neutral të aktiviteteve të VMRO-DPMNE-së. Për dallim nga kjo, për LSDM-në ka pasur 22-27% të raportimit të këtyre, kryesisht me ton negativ. Gjatë fushatës, transmetuesi publik dhe TV private *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* i kanë kushtuar raportim të konsiderueshëm aktiviteteve të ministrave të cilët kanë garuar si kandidatë, shpesh herë në mënyrë favorizuese dhe pozitive. Mediat kanë dështuar dukshëm në dallimin mes raportimit për zyrtarët në rolin e ministrave dhe si kandidatë.

Edicionet informative të TV private *Telma* dhe *Vesti 24* kanë pasur raportim më të baraspeshuar të aktiviteteve të fushatës për dy garuesit kryesorë, duke i dhënë proporcione të ngjashme raportimit për VMRO-DPMNE-në dhe LSDM-në.<sup>31</sup> Ndërkohë që toni i raportimit ka qenë kryesisht neutral në *Vesti 24*, TV *Telma* ka shfaqur qasje kritike në raportimin për qeverinë dhe partinë qeverisëse VMRO-DPMNE. TV *Alsat-M* i ka kushtuar 26% të raportimit të aktiviteteve të BDI-së, 21% për VMRO-DPMNE, 18% për LSDM dhe 17% për PDSH. TONI i raportimit ka qenë kryesisht neutral, ku BDI-së i është dhënë mbulim më pozitiv krahasuar me partitë tjera.

Llogaritur për të gjithë transmetuesit privatë të cilët janë monitoruar, rreth 40 orë të programit të paguar politik janë porositur nga VMRO-DPMNE dhe kandidati i tyre presidencial. GROM ka pasur rreth 7.5 orë, BDI 6.5 orë, LSDM 3.3 orë, si dhe 2 orë nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Popullore (VMRO-NP).<sup>32</sup>

### Kundërshtimet dhe paditë

Mekanizmi për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore ka mbetur joefektiv. Mungesa e afateve gjyqësore për zgjidhjen e lëndëve zgjedhore, në kombinim me të drejtën e kufizuar të votuesve për ndreqjen ligjore në çdo fazë të procesit zgjedhor, nuk e ka garantuar në tërësi ndreqjen efektive si që kërkohet me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.<sup>33</sup>

KSHZ ka refuzuar 791 aplikacione nga votuesit të cilët kanë kërkuar të përfshihen në listën zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në PDK Tiranë.<sup>34</sup> Prej tyre, 640 kanë parashtruar padi individuale në Gjykatën Administrative, e cila e ka ndryshuar vendimin e KSHZ-së, duke vendosur që meqë KSHZ tashmë ka konfirmuar se këta votues i përmbushin kriteret për të votuar jashtë vendit për zgjedhjet presidenciale, nuk mund të përjashtohen nga listat e votuesve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Pas shikimit të listës së votuesve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, BDI ka parashtruar kundërshtim në KSHZ, duke kërkuar që këta votues të mënjanohej nga lista zgjedhore, meqë janë banorë të përhershëm në Shqipëri. Ky kundërshtim është refuzuar nga KSHZ dhe Gjykata Administrative, në bazë të vendimeve paraprake. Edhe kundërshtimi i ngjashëm nga LSDM për mënjanimin e votuesve është refuzuar në dy nivelet.

<sup>31</sup> VMRO-DPMNE dhe LSDM kanë marrë 30 dhe 26% në TV *Telma*, gjegjësisht 29% dhe 30% në *Vesti 24*.

<sup>32</sup> LSDM dhe VMRO-NP i kanë raportuar MVZ të OSBE/ODIHR që kanë tentuar të blejnë më tepër kohë në TV *Sitel* dhe *Kanal 5*, por janë informuar që pjesa më e madhe e kohës është blerë nga garuesit tjerë.

<sup>33</sup> Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 përcakton që “të gjithë duhet të kenë të drejtë të mjeteve efektive të ndreqjes kundër vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor”. Shikoni edhe paragrafin II.3.3 të Kodit të Komisionit të Venedikut për praktikën e mirë në çështjet zgjedhore.

<sup>34</sup> Këta votues jetojnë në Pustec, Shqipëri dhe kanë shtetësi të dyfishtë.

Kundërshtimet ndaj keqpërdorimit të resurseve shtetërore dhe kërkesat për aprovimin e pagesave të reja buxhetore parashtrihen në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Sesionet e KSHPK-së nuk kanë qenë të hapura për publikun ose parashtruesit e kundërshtimeve. Nuk ekziston e drejta e ankesës ndaj vendimeve të Komisionit, të cilat nuk publikohen. KSHPK e ka informuar MVZ të OSBE/ODIHR-it që ka trajtuar rreth 1,200 kërkesa nga institucionet shtetërore për rritjen ose ndryshimin e pagesave buxhetore pas shpalljes së zgjedhjeve, që kryesisht lidhen me zgjatjen e kontratave të punësimit për nëpunësit publikë.<sup>35</sup>

### Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

Në KSHZ janë regjistruar gjithsej 610 vëzhgues ndërkombëtarë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale.<sup>36</sup> Grupet qytetare të vëzhgimit kanë dërguar një numër pak më të lartë të vëzhguesve, krahasuar me rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale. Dy organizatat joqeveritare (OJQ) me traditë më të gjatë në vëzhgimin e zgjedhjeve në vend (MOST dhe CIVIL) kanë regjistruar 2,413, gjegjësisht 113 vëzhgues. Asociacioni për aktivitete humanitare SINERGIJA ka regjistruar 5,050 vëzhgues, ndërsa Asociacioni i qytetarëve për demokratizim dhe ngritje të vetëdijes publike (VEPRO) nga Struga 2,321 vëzhgues.<sup>37</sup>

PDSH ka parashtruar kundërshtim në KSHZ duke e kërkuar anulimin e akreditimit për VEPRO, me pretendimin që vëzhguesit e saj i kanë udhëzuar votuesit të mos votojnë dhe i kanë shënuar emrat e atyre që kanë votuar më 13 prill. Kundërshtimi është refuzuar për mungesën e dëshmive.

### Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ka rrjedhur në mënyrë të papenguar dhe profesionale, ndonëse janë vërejtur disa parregullsi teknike gjatë ditës. KSHZ ka filluar me shpalljen e rezultateve gjatë mbrëmjes dhe i ka shpallur ato në ueb-faqe, të ndara sipas njësive dhe vendvotimeve, që është masë e mirë për avancimin e mëtejshëm të transparencës. Të dhënat preliminare të shpallura nga KSHZ tregojnë dalje prej 54% për zgjedhjet presidenciale dhe 64% për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Para fillimit të numërimit të votave, partia më e madhe opozitare ka shpallur që nuk do ta pranojë rezultatin e zgjedhjeve.

Votimi i hershëm është mbajtur më 26 prill për personat që votojnë në shtëpi dhe të burgosurit. Në përgjithësi, votimi i hershëm ka rrjedhur në mënyrë transparente dhe janë respektuar procedurat. Vlerësimi i përgjithshëm nga MNVZ ka qenë pozitiv. Por, fshehtësia e votës nuk ka qenë e sigurt në 16 prej 95 rasteve. Si edhe në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, MNVZ ka vërejtur disa raste ku të burgosurve me letërnjoftime të vlefshme nuk ju është lejuar të votojnë, meqë nuk kanë qenë të regjistruar në listën zgjedhore.

Vëzhguesit e MNVZ-së kanë pasur qasje të plotë dhe të pakufizuar gjatë hapjes së vendvotimeve. Procesi është vlerësuar si pozitiv në 88 prej 92 vëzhgimeve. Disa prej parregullsive procedurale i kanë përfshirë rastet kur nuk është treguar që kutitë e votimit janë të zbrazëta (15 raste), si dhe mosplotësimi i procesverbaleve të hapjes para hapjes së vendvotimeve (14 raste).

Në vlerësimin e përgjithshëm pozitiv nga vëzhguesit e MNVZ-së, procesi është vlerësuar si i mirë ose shumë i mirë në 96% të vëzhgimeve. Puna e KZ-ve dhe njohja e procedurave të votimit dhe transparenca

---

<sup>35</sup> Ndalohen artikujt e ri të të dalave buxhetore pas shpalljes së zgjedhjeve, në bazë të Nenit 8-a të Kodit Zgjedhor dhe Nenit 11 dhe 12 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit.

<sup>36</sup> Këtu përfshihen ambasadat e pranishme në vend, si dhe OJQ daneze Nisma për mbështetjen e lirisë dhe demokracisë (SILBA).

<sup>37</sup> Shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR kanë pohuar që SINERGIJA është e lidhur me VMRO-DPMNE, ndërsa VEPRO me BDI-në.

e procesit janë vlerësuar pozitivisht në 95%, gjegjësisht 97% të vëzhgimeve. Por, shumë KZ nuk e kanë respektuar udhëzimin e KSHZ-së për t'i këshilluar votuesit që mund të votojnë për dy zgjedhjet, ose vetëm për një. Është vërejtur dallim mes rajoneve etnike shqiptare ku anëtarët e KZ-ve i kanë dekurajuar votuesit nga marrja e fletëvotimit presidencial, kundrejt vendvotimeve në rajonet etnike maqedonase ku votuesve i janë dhënë automatikisht dy fletëvotimet. Parregullsia më e shpeshtë ka qenë votimi në grupe, që është vëzhguar në rreth 9% të vendvotimeve. Vëzhguesit nuk janë penguar dhe kanë pasur mundësi të vëzhgimit të procedurave në 99% të vendvotimeve.

Vlerësimi i përgjithshëm i numërimit ka qenë i mirë në 83 prej 98 numërimeve të vëzhguara. Por, në 17 raste janë raportuar parregullsi procedurale. Procesi ka qenë transparent dhe vëzhguesit e MNVZ-së ka pasur qasje të pakufizuar në numërim në të gjitha vendvotimet. Në 8 prej vendvotimeve të vëzhguara, disa anëtarë të KZ-ve kanë refuzuar ta nënshkruajnë procesverbalin. Më tej, në 37 vendvotime, KZ nuk e ka shpallur publikisht ekzemplarën e procesverbalit të rezultateve, si që kërkohet me ligj.

MNVZ e ka vëzhguar shpalljen në 76 prej 80 KKZ-ve dhe e ka vlerësuar procesin si të mirë ose shumë të mirë në 69 vëzhgime. Janë vërejtur mospërputhje serioze në procesverbalet e KZ-ve në 11 vëzhgime, por ato janë përmirësuar nga KKZ-të. Përfaqësuesit e autorizuar të partive politike dhe kandidatëve kanë qenë në 98% të vendvotimeve dhe KKZ-ve të vizituara nga MNVZ, ndërsa vëzhguesit qytetarë kanë qenë të pranishëm në 68% të vendvotimeve dhe 92% të KKZ-ve.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Sigurohen përkthime jozyrtare në gjuhën shqipe dhe maqedonase.*

---

## INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

---

**Shkup, 28 prill 2014** – MVZ i OSBE/ODIHR u hap në Shkup më 10 mars me 11 ekspertë në kryeqytet dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.

Në ditën e votimit janë deleguar 252 vëzhgues nga 32 shtete, përfshirë 206 vëzhguesit afatgjatë dhe afatshkurtër të OSBE/ODIHR, 31 parlamentarët dhe personeli i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, si dhe 15 nga PACE. Votimi është vëzhguar në 889 vendvotime në mbarë vendin. Procesi i shpalljes është vëzhguar në 76 KKZ.

Institucionet e përfaqësuara dëshirojnë t'i falënderojnë autoritetet për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për bashkëpunimin dhe sigurimin e dokumenteve për akreditim, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe organet tjera për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. Institucionet i shprehin falënderim edhe Misionit të OSBE-së në Shkup dhe institucionet tjera ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre.

### **Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni:**

- Ambasadorin Geert-Hinrich Ahrens, Shef i MVZ i OSBE/ODIHR në Shkup, (+389 (0)2 3121 657);
- Z. Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR, (+389 72 209 788 dhe +48 609 522 266) ose znj. Tamara Otiashvili, Këshilltare për zgjedhje në OSBE/ODIHR në Varshavë (389 77 553 814 ose +48 22 5200 680).
- Roberto Montella, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, (+389 (0)77 594 872 ose +43 699 104 286 81)
- Seksioni i komunikimit në PACE (+33 88 413 193)

### **Adresa e MVZ të OSBE/ODIHR**

Bul. Ilinden, nr.76, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3121 657, Faksi: +389 (0)2 3119 524, E-mail: [office@odhr.org.mk](mailto:office@odhr.org.mk)

Ueb-faqja: <http://www.osce.org/odhr/elections/116272>